REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.1325 Prot.

Maliq, më 02.03.2026

VENDIM
Nr.39, datë 27.02.2026
PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE PRIVATE QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT "ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË FSHATIN VASHTËMI TË BASHKISË MALIQ"

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenin 9, pika 1.2 gërma b dhe c, nenit 23, pika 7, nenin 54, nenin 55 pika 2 dhe 6 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjit Nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", i ndryshuar, projektit të hartuar nga Sektori i Hartimit dhe Implementimit të Projekteve dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë, për objektin "Zgjerimi i varrezave publike në fshatin Vashtemi të Bashkisë Maliq", Urdhërin Nr. 338, datë 09.07.2025 "*Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e situatës mbi ezaurimin e sipërfaqes së verrezave në fshatin Vashtëmi, Njësia Administrative Libonik,* Proces-verbalit të datës 11.07.2025, mbajtur nga grupi i punës. Këshilli Bashkiak Maliq,

VENDOSI:

1. Fillimin e proçedurave të shpronësimit për interes publik të pasurive private që preken nga zbatimi i projektit "Zgjerimi i varrezave publike në fshatin Vashtëmi të Bashkisë Maliq", sipas listës së pasurive, planeve të rilevimit dhe projektit të zgjerimit të varrezave që i bashkëlidhen këtij projekt-vendimi.
2. Sektori i Pronave Publike dhe Aseteve, të kryeje verifikimet e dokumentacionit ligjor (statusit juridik) pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të pasurive të evidentuara nga grupi i punës, si pasuri të paluajtshme që preken nga zbatimi i projektit, si dhe të vijojë procedurat e metejshme të përgatitjes së dokumentacionit të plotë që nevojitet për shpronësim për interes publik dhe dërgimin e kërkesës zyrtare pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësim, Tiranë.
3. Për zbatim ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Pronave Publike dhe Aseteve pranë Bashkisë Maliq.
4. Ky vendim hyn ne fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore",* i ndryshuar.

Miratuar me 20 vota
Vota Pro 20
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 02.03.2026

NË MUNGESË
DHE ME POROSI
ZV/KRYETARI I KËSHILLIT
Enida AVDOLLI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ